

## **MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E BRENDSHME, PROJEKTI “PËRBALLIMI DHE ZBUTJA RREZIKUT NGA FATKEQESITË”**

Raporti Përfundimtar, “Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare dhe vlerësues”, për periudhën e aktivitetit nga fillimi i projektit deri me datën 30.08.2013 kryer në Ministrinë e Brendshme, Projekti “Përballimi dhe zbutja rrezikut nga fatkeqësitë” me objekt: *"Mbi marrëveshjet e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet e tyre nëse ka, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimit; raportimi i tyre në Ministrinë e Financave; mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshje me huadhënësin; mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar; mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të përcaktuara sipas rastit në marrëveshjet me huadhënësit ose legjislacionin shqiptar, për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra e shërbime deri në lidhjen e kontratës; mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra e shërbime etj."* është miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 182 datë 31.12.2013.

Bazuar në nenin 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000 me shkresën nr. 736/8 prot., datë 31.12.2013, dërguar z. Saimir Tahiri, Ministër i Brendshëm, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave organizative, për shpërblim dëmi dhe disiplinore.

**Si masa organizative**, me afate të ndryshme zbatimi, midis të tjerave është rekomanduar që Ministria e Brendshme:

- të marrë masat e nevojshme të parashikuara në ligjet e ratifikimit të marrëveshjeve të financimit me hua dhe kredi për zbatimin në afat të fillimit dhe zbatimit të projekteve me financime të huaja; të marrë masa për të harmonizuar dhe koordinuar aktivitetin e strukturave përkatëse të përfshira në implementimin e projektit, duke synuar përmbushjen në afat dhe me cilësi të objektivave dhe komponentëve të projektit;
- të hartojë plan veprimi për rishikimin dhe përditësimin e të gjithë kuadrit ligjor lidhur me reagimin ndaj situatave të jashtëzakonshme, si dhe të hartojë kuadrin themelor rregullator, duke propaganduar ligjin e ri;
- të organizojë gjithë veprimtarinë e nevojshme për të hartuar dhe miratuar Strategjinë kombëtare për menaxhimin e riskut të katastrofave dhe programin e investimeve; si dhe në bashkëpunim me institucionet përkatëse, të marrin masa për hartimin e Strategjisë multimediatike të komunikimit publik, për ndërgjegjësimin e publikut, për përgatitjen dhe propagandimin e masave mbrojtëse dhe atyre të cilat ndikojnë në reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore;
- të hartojë procedura të detajuara për t'u ndjekur në përgjigje të situatave të jashtëzakonshme, për të bërë të mundur ndërhyrjet e shpeshta dhe të efektshme në rast ngjarjesh me përmasa katastrofike, si dhe të kryejë trajnime të specializuara për personat të cilët reagojnë të parët ndaj situatave të jashtëzakonshme;
- t'i kërkojë Ministrisë së Financave marrjen e masave që të bëhet e mundur përdorimi publik i faqes zyrtare të internetit interaktiv dhe tre moduleve të ndërgjegjësimit të konsumatorit;
- t'i kërkojë Ministrisë së Financave marrjen e masave për futjen dhe shtrirjen e CRIF-it (Kompania e sigurimeve të katastrofave në Evropën Juglindore) në tregun e sigurimeve shqiptare për sigurimin nga katastrofat, si dhe t'i kërkojë Autoritetit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve realizimin e marrëveshjes bilaterale me CRIF-in me qëllim që CRIF-i të shpërndajë shërbimet e veta përmes kompanive lokale të sigurimeve

- gjatë zbatimit të projekteve me financime të huaja të hartojë dhe zbatojë kontrata pune në përputhje me legjislacionin shqiptar mbi marrëdhëniet e punës, për të shmangur informalitetin në tregun e punës dhe për të siguruar mbrojtjen sociale të të punësuarve;

- të zbatojë kriteret dhe dokumentet e përcaktuara për lëvizjen e aseteve, në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” etj.

**Masat për shpërblim dëmi përfshijnë** kërkimin në rrugë ligjore për shpërblimin e dëmit prej **838,070 lekë** të shpenzuar për automjetet mbi normën e konsumit të karburantit për 100 km, shkaktuar nga menaxhimi i gabuar i z. [REDAKTUAR] me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Emergjencave Civile në cilësinë e Drejtorit të Projektit dhe z. [REDAKTUAR] me detyrë financier i projektit;

si dhe kërkimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe shkallët e gjykimit, derdhja në organet tatimore shumë prej **2,417,630 lekë** kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, nga të cilat 1,445,581 lekë nga Ministria e Brendshme në cilësinë e punëdhënësit dhe z. [REDAKTUAR], pjesa e detyrimit si punëmarrës në shumën 453,139.60 lekë; z. [REDAKTUAR] në shumën 337,469 lekë; si dhe z. [REDAKTUAR], pjesa e detyrimit si punëmarrës në shumën 181,440 lekë.

Bazuar në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 37 është kërkuar **fillimi i procedurave për dhënien e masës disiplinore “Ndërprerje e kontratës së konsulencës”** për: **1. Punonjësin [REDAKTUAR], me detyrë menaxher i prokurimeve**, pasi: si pjesë e strukturës së ngarkuar për implementimin e projektit nuk ka hartuar dhe formuluar rregullisht dhe në vijimësi evidenca, informacione, raporte etj; nuk janë paguar në organet tatimore detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore; në një procedurë tenderimi, numri i ofertave të dërguara ka qenë më pak se tre në kundërshtim me Udhëzuesit e BB; mallrat dhe pajisjet në disa raste nuk janë testuar gjatë fazës së pranimi; është përdorur procedura e kontraktimit të drejtpërdrejtë në përgjigje të fatkeqësive natyrore pas përfundimit të saj; nuk është përcaktuar në DST demonstrimi i pagesave të detyrimeve tatimore si dhe licencimi i tyre në këtë drejtim; është nënshkruar Certifikata e pranimi operacional pa përfunduar plotësimi i detyrimeve kontraktore; është amenduar kontrata konsulencës për shtyrje e pa bazuar në kushtet e saj; kostoja e shërbimit të konsulencës për zhvillimin e eurokodeve është rritur së paku me 10,660 euro; mungon korrespondenca shkresore në kuadër të kontratës “Hartimi i Strategjisë Kombëtare për reduktimin e rrezikut” për pranimin në mënyrë të pëlqyeshme të Raporteve, si dhe nuk duhej të ishin paguar 80 % e kontratës etj.

**2. Z. [REDAKTUAR] me detyrë Financier i Projektit**, pasi: nuk është evidentuar, vlerësuar dhe raportuar në MF, rivlerësimi i kredisë IDA, si pasojë e ndryshimit të kursit të këmbimit; nuk janë paguar në organet tatimore detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 1,445,581 lekë; janë marrë në dorëzim automjete, pa përcaktuar personin përgjegjës material dhe inventarin e tyre; mangësi në dokumentacionin e zbatimit të kontratave; në një rast, kontrata është likuiduar, ndërsa pajisjet nuk janë marrë në dorëzim; në zbatimin e kontratave për blerjen e karburantit dhe përdorimi i tij janë regjistruar si të konsumuara për periudhën pra para furnizimit 1,315 litra karburant; ka mangësi në dokumentacionin justifikues për harxhimin e karburantit; norma e konsumit të karburantit për 100 km është vendosur 4.5 litra më shumë, në vlerën 838,070 lekë; mangësi në plotësimin e dokumentacionit financiar justifikues së fletë-dalje, fletë udhëtimi etj; është paguar në kundërshtim me strukturën e pagesave; nuk është dokumentuar zbatimi i procedurave lidhur me plotësimin e specifikimeve teknike dhe kryerjes së shërbimeve të trajnimit etj.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

*Të tjera:* Është ngarkuar Ministria e Brendshme të njoftojë Departamentin e Administratës Publike për rezultatet e auditimit të KLSH, pasi gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin e Auditimit janë konstatuar përgjegjësi të natyrës manaxhuese për z. [REDAKTUAR] me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Emergjencave Civile në cilësinë e Drejtorit të Projektit, për të cilin nuk janë rekomanduar masa disiplinore, duke i konsideruar të ezauruara, sepse ka ndërprerë marrëdhëniet e punës.

*Shënim:* Auditimi u krye nga z. Gjovalin Preçi përgjegjës i grupit, z. Andi Buzo, z. Abdulla Duka dhe z. Agron Maksutaj. Më tej u shqyrtua nga Drejtori i Departamentit z. Xhafer Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë z. Ermal Yzeiraj dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm zj. Helga Vukaj.

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**